



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
DHOMA KOMBËTARE E NOTERISË  
DEGA VENDORE TIRANË

NOTER AIDA A. HOXHA  
ADRESA MINE PEZA, NR.83/1  
TEL: 689090075

# REDAKTIM DHE VËRTETIM I AKTEVE TË SH.P.K-VE

Nr. repertori: 97

Nr. koleksioni: 19

Tirane më 08/01/2024

gjëjet referuese:

Ligji nr. 7850, datë 29/07/1994 "Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar

Ligji nr. 9887, date 10/03/2008 "Për mbrojtjen e të dhënave personale", i ndryshuar

Ligji nr. 110, datë 20/12/2018 "Për Noterinë", i ndryshuar

ky dokument noterial përbëhet nga 10 fletë



A2024051010002659738



A2024051010002659738

## STATUT DHE AKT THEMELIMI I SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR "DHERMI RESIDENCE" SHPK

Sot, më datë 08/01/2024 (dymijënjëzetëkatër), para meje Notere AIDA A. HOXHA, anëtare në Dhomën Kombëtare të Noterisë, Dega Vendore TIRANË, me zyrë në adresën Tirane, MINE PEZA, NR.83/1, u paraqit personalisht:

### ORTAKËT:

**Benard Martini**, atësia Tom, amësia Roze, shtetas Shqiptar, lindur në Mjedë, Shkodër dhe banues në TIRANË, me adresë Margarita Tutulani; Nd. 6; H. 2; Ap. 43; Njësia Administrative Nr. 5; Njësia Bashkiake Nr. 5; 1019; Tiranë, lindur më 22/12/1982, gjendja civile "i martuar", madhor, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, për identitetin e të cilit u garantova me Leternjoftim ID nr. 034037524 dhe nr. personal I21222153E, .

**Gerjon Gjoka**, atësia Gentjan, amësia Jonida, shtetas Shqiptar, lindur në Tiranë dhe banues në HIMARË, me adresë Palas Dhermi 04200064; Nd. 197; H. 1; Himarë; Dhermi; 9422; Himarë, lindur më 27/10/1999, gjendja civile "beqar", madhor, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, për identitetin e të cilit u garantova me Leternjoftim ID nr. 035486211 dhe nr. personal J91027040W, .

ne cilesine e Ortakeve Themelues te shoqerise me pergjegjesi te kufizuar "DHERMI RESIDENCE" shpk.

Personat e mesiperme jane madhore e me zotesi te plote juridike per te vepruar. Ata me vullnetin e tyre te lire e te plote, nepermjet ketij Statuti themelojne nje shoqeri me pergjegjesi te kufizuar sipas legjislacionit shqiptar ne fuqi dhe kushteve te meposhtme.

### KREU I

## KRIJIMI, FORMA, QELLIMI, OBJEKTI, KOHËZGJATJA, EMËRTIMI, SELIA

### NENI 1

## KRIJIMI I SHOQËRISË

Sot me date 08/01/2024, në qytetin e Tiranës është themeluar shoqëria me përgjegjësi të kufizuar me emërtimin "DHERMI RESIDENCE" Sh.p.k. (më poshtë referuar si "Shoqëria").

Shoqëria është person juridik shqiptar dhe funksionon në përputhje me kërkesat e ligjit Nr. 9901 datë 14.04.2008 "Për Tregëtarët dhe Shoqëritë Tregtare".

Shoqëria gëzon të drejta si person juridik shqiptar që prej datës në të cilën Qendra Kombëtare e Regjistrimit ka dhënë aprovimin për themelimin e saj.

Shoqëria e ushtron aktivitetin e saj në përputhje me legjislacionin shqiptar dhe me dispozitat e parashikuara në dokumentat themeluese (Akt Themelimi dhe Statut).

### NENI 2

## FORMA E SHOQËRISË

Shoqëria do të ketë formën e shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar, për sa kohë që ortakët e kësaj shoqërie nuk do të marrin një vendim për ndryshimin e formës së saj ligjore.

Veprimtaria e shoqërisë do të rregullohet nga dispozitat përkatëse të ligjit Nr. 9901 datë 14.04.2008 "Për Tregëtarët dhe Shoqëritë Tregtare".

### NENI 3

## ORTAKËT

Shoqëria krijohet nga ortakët themelues:

**Benard Martini**, atësia Tom, lindur me 22.12.1982 ne Mjede, Shqiperi dhe banues ne rr. Margarita Tutulani, Njesia Administrative Nr. 5 ,Ap 43 Tirane Tirane, madhor me zotesi te plote juridike per te vepruar, identifikuar me nr. personal I21222153E.



A2024051010002659738

**Gerjon Gjoka**, atesia Gentjan, lindur me 27.10.1999, ne Tirane Shqiperi dhe banues ne Himare, madhor me zotesi te plote juridike per te vepruar, identifikuar me nr. personal J91027040W.

#### **NENI 4**

#### **EMERTIMI**

Emertimi i shkurtër i shoqërisë është "DHERMI RESIDENCE" Sh.p.k. Në të gjitha aktet dhe dokumentet e nxjerra nga shoqëria, emërtimi i shoqërisë do të ndiqet nga fjalët "Shoqëri me përgjegjësi të kufizuar" ose inicialet Sh.p.k .

#### **NENI 5**

#### **SELIA E SHOQERISE**

Shoqëria e ka selinë në qytetin e Tiranës, në adresën Rruga: "E DURRESIT, PASURIA NR.4/12+3-B/2 ZONA KADASTRALE 8210", Tiranë, Shqipëri.

Përveç veprimtarisë në nivel lokal, shoqëria ka të drejtën e krijimit dhe mbylljes së filialeve, agjencive dhe zyrave të përfaqësimit brenda apo jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë.

Selia mund të transferohet në çdo vend tjetër brenda territorit të Republikës së Shqipërisë, me një vendim të ortakëve të saj.

#### **NENI 6**

#### **KOHEZGJATJA**

Kohëzgjatja e shoqërisë është për një afat 10 vjecar me te drejte shtyrje .

Në përputhje me këtë statut, shoqëria mund të mbyllë veprimtarinë e saj, ose mund ta zgjasë kur e sheh të arsyeshme, apo në rastet e parashikuara nga ligji.

#### **NENI 7**

#### **QELLIMI DHE OBJEKTI I VEPRIMTARISE**

Objekti i veprimtarisë së shoqërisë Sh.p.k do të jete:

Projektim, zbatim, ne fushen e ndertimeve civile, turistike, bujqesore, ekonomike, veshje fasadash, banesa, hotele, vila banimi , objekte kult, rruge, infrastrukture, rikonstruksione civile, mirembajtje, zhvillim dekori ne mjedise urbane. Prodhim, perpunim i materialeve te ndertimit, transportimi dhe tregtim i tyre. Magazinimi dhe shperndarja e materialeve te ndertimit. Import dhe eksport i materialeve te ndertimit. Tregtim i tyre me shumice dhe pakice. Ndertim i ndertesave rezidenciale dhe jorezidenciale, shitje pasurie te paluajtshme. Te zhvilloje cdo veprimtari dhe aktivitet tjetet ne perputhje me legjislacionin shqiptar

#### **KREU II**

#### **KAPITALI THEMELTAR, KUOTAT DHE KALIMI I KUOTAVE**

#### **NENI 8**

#### **KAPITALI THEMELTAR**

8.1 Kapitali themeltar fillestar i Shoqerise me përgjegjësi të kufizuara është 100,000 Leke (te reja). Ai mund të rritet me vendim të ortakëve sipas normave të fushës në fuqi.

8.2 Pjesëmarrja e themeluesve në kapitalin e shoqërisë është në përputhje me kontributet e tyre të mëposhtme:

1.Ortaku Themelues Benard Martini - zoteron 1 (një) kuote me vlerë të përgjithshme 50,000 Leke (te reja) që përben 50 % të kapitalit themeltar të shoqërisë.

2. Ortaku Themelues Gerjon Gjoka zoteron 1 (një) kuote me vlerë të përgjithshme 50,000 Leke (te reja) që përben 50 % të kapitalit themeltar të shoqërisë.

#### **Neni 9**

#### **ZMADHIMI DHE ZVOGELIMI I KAPITALIT**



A2024051010002659738

Kapitali i shoqërisë mund të zmadhohet nepermjet nënshkrimeve të pjesëve të kapitalit themeltar për kontributet në para dhe me anë të kontributeve në natyrë, nepermjet emerimit nga gjykata kompetente e një eksperti të autorizuar për keto kontribute sipas kërkesës së administratorit.

Në asnjë rast shumica nuk mund të detyrojë një ortak për të rritur angazhimin e tij në kapitalin themeltar të shoqërisë.

Zvogëlimi i kapitalit lejohet nga asambleja e ortakëve, e cila merr vendim në të njëjtat kushte që kërkohen për ndryshimin e statutit.

Në të gjitha rastet zvogëlimi i prek ortakët në të njëjtën masë ndaj pjesëve të kapitalit që përfaqësojnë.

## Neni 10 TRANSFERIMI I KAPITALIT

Kuotat e kapitalit të një shoqërie me përgjegjësi të kufizuar e të drejtat që rrjedhin prej tyre mund të fitohen apo kalohen nëpërmjet:

- a) kontributit në kapitalin e shoqërisë;
- b) shitblerjes;
- c) trashëgimisë;
- ç) dhurimit;
- d) çdo mënyre tjetër të parashikuar me ligj.

Pjesët e kapitalit themeltar janë lirisht të transferueshme ndërmjet ortakëve, për sa nuk parashikohet ndryshe në statut.

Pjesët e kapitalit themeltar janë lirisht të transferueshme me rrugë trashëgimie.

## KREU III ORGANET VENDIMARRESE DHE DREJTUESE

### Neni 11 ORGANI VENDIMARRES

Asambleja e Ortakëve është organi i vetëm vendimtarës i shoqërisë.


Asambleja e Ortakëve është organi i vetëm vendimtarës i shoqërisë që miraton çdo ndryshim të statutit sipas modaliteteve të percaktuara në ligj.

Asambleja e përgjithshme e ortakëve është përgjegjëse për marrjen e vendimeve për shoqërinë për çështjet e mëposhtme:

- a) përcaktimin e politikave tregtare të shoqërisë;
- b) ndryshimet e statutit;
- c) emërimin e shkarkimin e administratorëve;
- ç) emërimin e shkarkimin i likuiduesve dhe të ekspertëve kontabël të autorizuar;
- d) përcaktimin e shpërblimeve për personat e përmendur në shkronjat "c" dhe "ç" të kësaj pike;
- dh) mbikëqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratorët, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
- e) miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
- ë) zmadhimin dhe zvogëlimin e kapitalit;
- f) pjesëtimin e kuotave dhe anulimin e tyre;
- g) përfaqësimin e shoqërisë në gjykatë dhe në procedimet e tjera ndaj administratorëve;
- gj) riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë;
- h) miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të asamblesë;
- i) çështje të tjera të parashikuara nga ligji apo statuti.

Ortaku mund të përfaqësohet në asamblenë e përgjithshme, në bazë të një autorizimi nga një ortak tjetër apo nga një person i tretë.

Administratori i shoqërisë nuk mund të veprojë si përfaqësues i ortakëve në asamblenë e përgjithshme.



A2024051010002659738

Autorizimi mund të jepet vetëm për një mbledhje të asamblesë së përgjithshme, e cila përfshin edhe mbledhjet vijuese me të njëjtin rend dite.

#### Neni 12

### MENYRA E THIRRJES SE MBLEDHJES SE ASAMBLESE SE PERGJITHSHME

Asambleja e përgjithshme thirret nëpërmjet një njoftimi me shkresë ose me njoftim nëpërmjet postës elektronike. Njoftimi me shkresë apo me mesazh elektronik duhet të përmbajë vendin, datën, orën e mbledhjes dhe rendin e ditës e t'u dërgohet të gjithë ortakëve, jo më vonë se 7 ditë përpara datës së parashikuar për mbledhjen e asamblesë.

Kur asambleja e përgjithshme nuk është thirrur sipas pikës 1 të këtij neni, ajo mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse të gjithë ortakët janë dakord, për të marrë vendime, pavarësisht parregullsisë.

#### Neni 13

### KUORUMI

Në rastin e marrjes së vendimeve, që kërkojnë një shumicë të zakonshme, asambleja e përgjithshme mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse marrin pjesë ortakët me të drejtë vote, që zotërojnë më shumë se 30 për qind të kuotave.

Në rastin kur asambleja e përgjithshme duhet të vendosë për çështje, të cilat kërkojnë shumicë të kualifikuar sipas nenit 87 të ligjit " Per Tregtaret dhe Shoqëritë Tregtare ", ajo mund të marrë vendime të vlefshme vetëm, nëse ortakët që zotërojnë më shumë se gjysmën e numrit total të votave, janë të pranishëm personalisht, votojnë me shkresë, apo mjete elektronike, sipas parashikimeve të pikës 3 të nenit 88 të këtij ligji.

Nëse asambleja e përgjithshme nuk mund të mbledhet për shkak të mungesës së kuorumit të përmendur me lart, asambleja mbledhet përsëri jo më vonë se 30 ditë, me të njëjtin rend dite.

#### Neni 14

### MARRJA E VENDIMEVE

Asambleja e përgjithshme vendos me tri të katërtat e votave të zoteruesve të kapitalit, të ortakëve pjesëmarrës, për ndryshimin e statutit, zmadhimin ose zvogëlimin e kapitalit të regjistruar, shpërndarjen e fitimeve, riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë.

Asambleja e përgjithshme vendos me shumicën e thjeshte të votave të ortakëve pjesëmarrës, për çështje të tjera si :

- a) përcaktimi i politikave tregtare të shoqërisë;
  - b) emërimin dhe shkarkimin e administratorit;
  - c) emërimin e shkarkimin i likuiduesve dhe të ekspertëve kontabël të autorizuar;
  - ç) përcaktimin e shpërblimeve
  - d) mbikëqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratorët, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecursisë së veprimtarisë;
  - e) përfaqësimin e shoqërisë në gjykatë dhe në procedimet e tjera ndaj administratorëve;
  - f) miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të asamblesë;
- Cdo ndryshim statuti duhet të depozitohet pranë QKR për të pasqyruar ndryshimet në skeden e shoqërisë.

#### Neni 15

### PERJASHTIMI NGA E DREJTA E VOTES

1.Ortaku nuk mund të ushtrojë të drejtën e votës nëse asambleja e përgjithshme merr vendim për:

- a) vlerësimin e veprimtarisë së tij;
- b) shuarjen e ndonjë detyrimi në ngarkim të tij;
- c) ngritjen e një padie ndaj tij nga shoqëria;
- ç) dhënien ose jo të përfitimeve të reja.

2. Kur ortaku përfaqësohet nga një përfaqësues i autorizuar, i autorizuari vlerësohet të jetë në të njëjtin konflikt interesi, ashtu si dhe ortaku, të cilin përfaqëson.



A2024051010002659738

## Neni 16 ADMINISTRATORI

(1) Asambleja e përgjithshme emëron një ose më shumë persona fizikë si administratorë të shoqërisë. Afati i emërimit, është 5 (pese) vit me të drejtë ripërtëritjeje. Emërimi i administratorëve prodhon efekte pas regjistrimit në Qendrën Kombëtare të Biznesit.

(2) Si administrator i parë i shoqërisë deri në emërimin e tij nga mbledhja e parë e Asamblesë së Përgjithshme do të caktohet Zoti:

Z. Benard Martini lindur me 22.12.1982 ne Mjede ,ALB , madhor, me zotesi te plote juridike per te vepruar, banues ne Tirane mbajtes i leternjoftimit nr. 025259590 dhe nr. Personal I21222153E

## Neni 17 KOMPETENCAT E ADMINISTRATORIT

Administratori ka të drejtë e detyrohet të:

- a) kryejë të gjitha veprimet e administrimit të veprimtarisë tregtare të shoqërisë, duke zbatuar politikat tregtare, të vendosura nga asambleja e përgjithshme;
- b) përfaqësojë shoqërinë tregtare;
- c) kujdeset për mbajtjen e saktë e të rregullt të dokumenteve dhe të librave kontabël të shoqërisë;
- ç) përgatit dhe nënshkruan bilancin vjetor, bilancin e konsoliduar dhe raportin e ecurisë së veprimtarisë dhe, së bashku me propozimet për shpërndarjen e fitimeve, i paraqet këto dokumente përpara asamblesë së përgjithshme për miratim;
- d) krijon një sistem paralajmërimi në kohën e duhur për rrethanat, që kërcënojnë mbarëvajtjen e veprimtarisë dhe ekzistencën e shoqërisë;
- dh) kryen regjistrimet dhe dërgon të dhënat e detyrueshme të shoqërisë, siç parashikohet në ligjin për Qendrën Kombëtare të Biznesit;
- e) raporton përpara asamblesë së përgjithshme në lidhje me zbatimin e politikave tregtare dhe me realizimin e veprimeve të posaçme me rëndësi të veçantë për veprimtarinë e shoqërisë tregtare;
- ë) kryen detyra të tjera të përcaktuara në ligj dhe në statut.

## Neni 18 PERGJEGJESITE E ADMINISTRATORIT

Administratori është përgjegjës individualisht, ndaj shoqërisë ose ndaj të tretëve, për shkelje të ligjeve, për shkelje të statutit, apo për faje të kryera gjatë administrimit të shoqërisë.

Pasojat e marrëveshjeve të pamiratuara nga asambleja që i sjellin dëm shoqërisë, i ngarkohen administratorit dhe ortakut që ka bërë marrëveshjen, për të përballuar në mënyrë individuale ose solidarisht sipas rastit pasojat përkatëse.

Përveç sa është parashikuar në dispozitat e përgjithshme të detyrimit të besnikërisë, sipas neneve 14, 15, 17 e 18 të ligjit "Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare", administratori detyrohet:

1. a) të kryejë detyrat e tij të përcaktuara në ligj dhe në statut në mirëbesim e në interesin më të mirë të shoqërisë në tërësi, duke i kushtuar vëmendje të veçantë ndikimit të veprimtarisë së shoqërisë në mjedis;
- b) të ushtrojë kompetencat që i njihen në ligj dhe në statut vetëm për arritjen e qëllimeve të përcaktuara në këto dispozita;
- c) të vlerësojë me përgjegjësi çështjet, për të cilat merret vendim;
- ç) të parandalojë dhe mënjanojë rastet e konfliktit, prezent apo të mundshëm, të interesave personalë me ata të shoqërisë;
- d) të ushtrojë detyrat e tij me profesionalizmin dhe kujdesin e nevojshëm.



A2024051010002659738

2. Administratori, gjatë kryerjes së detyrave të tij, përgjigjet ndaj shoqërisë për çdo veprim ose mosveprim, që lidhet në mënyrë të arsyeshme me qëllimet e shoqërisë tregtare, me përjashtim të rasteve kur, në bazë të hetimit dhe vlerësimit të informacioneve përkatëse, veprimi ose mosveprimi është kryer në mirëbesim.

3. Nëse administratori vepron në kundërshtim me detyrat dhe shkel standardet profesionale, sipas pikave 1 e 2 të këtij neni, është i detyruar t'i dëmshpërblejë shoqërisë dëmet, që rrjedhin nga kryerja e shkeljes, si dhe t'i kalojë çdo fitim personal që ata apo personat e lidhur me ta kanë realizuar nga këto veprime të parregullta. Administratori ka barrën e provës për të vërtetuar kryerjen e detyrave të tyre në mënyrë të rregullt e sipas standardeve të kërkuara. Kur shkelja është kryer nga më shumë se një administrator, ata përgjigjen ndaj shoqërisë në mënyrë solidare.

4. Në mënyrë të veçantë, por pa u kufizuar në to, administratori është i detyruar t'i dëmshpërblejë shoqërisë dëmet e shkaktuara, nëse, në kundërshtim me dispozitat e ligjit "Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare, kryen veprimet e mëposhtme:

- a) u kthen ortakëve kontributet;
- b) u paguan ortakëve interesa apo dividendë;
- c) u shpërndan aktivet shoqërisë;
- ç) lejon që shoqëria të vazhdojë veprimtarinë tregtare, kur, në bazë të gjendjes financiare, duhej të parashikohej që shoqëria nuk do të kishte aftësi paguese për të shlyer detyrimet;
- d) jep kredi.

Përveç padisë për shlyerjen e dëmit që i ngarkohet personalisht administratorit, ortakët individualisht ose së bashku, kanë të drejtë të ngrenë padi penale kundër administratorit.

Paditësit kanë të drejtë të ndjekin në rrugë ligjore shlyerjen e plotë të dëmit që i është shkaktuar shoqërisë, përfshirë edhe dëmshpërblimin financiar, nëse është e nevojshme. Asnjë vendim i asamblesë nuk mund të ndalojë ngritjen e kërkesë padisë kundër administratorit për gabimet e kryera prej tij gjatë ushtrimit të detyrës.

#### **Kreu IV VITI FINANCIAR - EKSPERTET**

##### **Neni 19 VITI FINANCIAR**

Viti financiar i Shoqerise fillon me 1 Janar dhe perfundon me 31 Dhjetor. Perjashtimisht, viti i pare financiar fillon nga data e regjistrimit te shoqerise ne Qendren Kombetare te Biznesit dhe mbyllet me 31 Dhjetor.

##### **Neni 20 EKSPERTET**

Eksperti ka per detyre qe te kontrolloje te gjithë dokumentacionin kontabel te veprimtarise ekonomiko tregtare te shoqerise, ate gjithëvjeter dhe ate ne lidhje me kontrollet periodike te ushtruara prej tij per rastet kur ai eshte ngarkuar dhe ka kryer nje gje te tille i ngarkuar nga ana e ortakeve.

Ne perfundim te kontrollit eksperti kontabel i autorizuar perгатit raportin me shkrim per nxjerrjen e rezultatit te bilancit financiar vjetor si dhe per ate per kontrollet periodike te ushtruara, te cilat eshte i detyruar qe t'ja paraqese e dorezoje ne kohe ortakeve per t'i shqyrtuar e miratuar mbi bazen e te drejtes vendimore qe ka.

#### **Kreu V PRISHJA – RIORGANIZIMI I SHOQERISE**

##### **Neni 21 PRISHJA DHE LIKUIDIMI**



A2024051010002659738

Shperndarja ose prishja e shoqerise mund të behet ne cdo kohe :

- a) kur mbaron kohëzgjatja e parashikuar në themelimin e saj;
- b) me vendim të Asamblese se Ortakeve;
- c) me hapjen e procedurave të falimentimit;
- ç) nëse nuk ka kryer veprimtari tregtare për dy vjet dhe nuk është njoftuar pezullimi i veprimtarisë në përputhje me pikën 3 të nenit 43 të ligjit nr.9723, datë 3.5.2007 “Për Qendrën Kombëtare të Biznesit”;
- d) me vendim të gjykatës;

Ne kete rast Ortaket merrin vendim me shkrim ne të cilin parashikojne menyren e likuidimit të shoqerise, duke caktuar 1 apo disa likuidatore dhe shenuar ne cdo dokument të nxjerre prej tij emrin e likuidatorit dhe emertesën shtese “ Shoqeri ne likuidim e siper “.

Prishja e shoqërive tregtare ka si pasojë hapjen e procedurave të likuidimit në gjendjen e aftësisë paguese, me përjashtim të rasteve kur është nisur një procedurë falimentimi.

Likuidimi kryhet nga likuiduesit e emëruar nga Ortaket.

Nëse Ortaket nuk marrin një vendim për emërimin e likuiduesve, brenda 30 ditëve pas prishjes, çdo person i interesuar mund t’i drejtohet gjykatës, për të caktuar një likuidues.

#### Neni 22

### RIORGANIZIMI I SHOQERISE BASHKIMI - NDARJA

Shoqëria mund të ndahet, bashkohet sipas Vendimit të Mbledhjes së Përgjithshme të Asamblesë së Ortakeve, në përputhje me dispozitat ligjore të parashikuara në Pjesën IX të Ligjit 9901 datë 14.04.2012 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare.”

#### Neni 23

### BAZA LIGJORE

Shoqëria do të zhvillojë aktivitetin e tij në përputhje të plote me kete statut dhe dispozitat e legjislacionit shqiptar.

Per sa nuk parashikohet ne kete statut, do të zbatohen dispozitat e ligjit "Per tregtarët dhe shoqërite tregtare", Kodit Civil dhe çfaredo ligji tjetër specifik ne Republikën e Shqipërisë.

#### Neni 24

### MOSMARREVEESHJET

Per mosmarreveshjet qe mund te lindin ne lidhje me zbatimin apo interpretimin e ketij statuti, si dhe per çdo mosmarreveshje qe mund te linde midis Shoqerise dhe te treteve, do te jete kompetente Gjykata e Shkalles se Pare te Juridiksionit te Pergjithshem Tirane.

Une Noterja pasi ia lexova me ze te larte tekstin e ketij Statuti te shoqerise, dhe per identitetin e te cileve mora dijeni nga dokumentet e tyre personale, ata u njohen me permbajtjen e ketij dokumenti, dhe pasi ata e gjejne permbajtjen e Statutit te shoqerise ne përputhje me vullnetin e tyre te plote e te lire, nenshkruajne rregullisht ne pranine time dhe une Noterja vertetoj kete akt sipas ligjit

### ORTAKET

### E SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR “DHERMI RESIDENCE” shpk

Z.Benard MARTINI

*Z. Benard Martini*

*[Signature]*

Z.Gerjon GJOKA

*Z. Gerjon Gjoka*

NOTERE Aida A. Hoxha

*Aida A. Hoxha*





## AKTI I THEMELIMIT I SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR "DHERMI RESIDENCE "SHPK

**Benard Martini**, atesia Tom, lindur me 22.12.1982, ne Mjede, Shqiperi dhe banues ne rr. Margarita Tutulani, Njesia Administrative Nr. 5, Ap 43 Tirane, madhor me zotesi te plote juridike per te vepruar, identifikuar me nr. personal I21222153E.

**Gerjon Gjoka**, atesia Gentjan, lindur me 27.10.1999, ne Tirane Shqiperi dhe banues ne Tirane, madhor me zotesi te plote juridike per te vepruar, identifikuar me nr. personal J91027040W;

ne cilesine e Ortakeve Themelues te shoqerise me pergjegjesi te kufizuar "DHERMI RESIDENCE" shpk.

Personat e mesiperm jane madhore e me zotesi te plote juridike per te vepruar. Ata me vullnetin e tyre te lire e te plote, nepermjet ketij akti themelojne nje shoqeri me pergjegjesi te kufizuar sipas legjislacionit shqiptar ne fuqi dhe kushteve te meposhtme.

### **Neni 1** **Emertimi**

Emeri i shoqerise eshte "DHERMI RESIDENCE." shpk.", me poshte e quajtur "Shoqeria".

### **Neni 2** **Objekti**

Shoqëria me përgjegjësi të kufizuar do të zhvillojë aktivitetet me objektin e mëposhtëm:

Projektim, zbatim, ne fushen e ndertimeve civile, turistike, bujqesore, ekonomike, veshje fasadash, banesa, hotele, vila banimi ,objekte kulti, rruge, infrastukture, rikonstruksione civile, mirembajtje, zhvillim dekori ne mjedise urbane. Prodhim, perpunim i materialeve te ndertimit, transportimi dhe tregtim i tyre. Magazinimi dhe shperndarja e materialeve te ndertimit.. Import dhe eksport i materialeve te ndertimit. Tregtim i tyre me shumice dhe pakice.Ndertim i ndertesave rezidenciale dhe jorezidenciale ,shitje pasurie te paluajteshme . Te zhvilloje cdo veprimtari dhe aktivitet tjeter ne perputhje me legjislacionin shqiptar.

### **Neni 3** **Selia**

Shoqëria e ka selinë e regjistruar në adresën: Rruga: "E DURRESIT ,PASURIA NR.4/12+3-B/2 ZONA KADASTRALE 8210 ", Tirane, Shqiperi.

Shoqeria mund te hape edhe zyra perfaqesie, dege, te krijoje filiale dhe/ose te realizoje çdo lloj pjesemarrje ne shoqeri te tjera, siç parashikohet nga ligji, si brenda ashtu edhe jashte Republikes se Shqiperise, sipas vendimit te Asamblese se Ortakeve te marre me shumice te thjeshte votash.

### **Neni 4** **Kohezgjatja**

1. Shoqeria do te zhvilloje aktivitetin qe ka per objekt per nje afat 10 Vjeçar ,me te drejte shtyrje .

### **Neni 5** **Kapitali Themeltar**

5.1. Kapitali themeltar i Shoqerise me përgjegjësi të kufizuara është 100,000 (njqeinde mije)leke



A2024051010002659738

Pjesëmarrja e themeluesve në kapitalin e shoqërisë është në përputhje me kontributet e tyre të mëposhtme, si vijon:

**1. Ortaku Themelues Benard Martini** -zoteron 1 (një) kuote me vlerë të përgjithshme 50,000 Leke(te reja) që përben 50 % % të kapitalit themeltar të shoqërisë.

**2. Ortaku Themelues Gerjon Gjoka** zoteron 1 (një) kuote me vlerë të përgjithshme 50,000 Leke(te reja) që përben 50 % të kapitalit themeltar të shoqërisë.

5.2 Pjeset e kapitalit jane lirisht te transferueshme ne çdo moment sipas kushteve te parashikuara nga ligji shqiptar, me kufizimet e percaktuara ne pikat 5.3 dhe 5.4 me poshte.

5.3 Ne rast se njeri nga ortakët kerkon te shese nje pjese ose te gjitha kuotat qe ai zoteron ne shoqeri, ai eshte i detyruar qe t'ia ofroje paraprakisht keto kuota ortakut tjetër te shoqerise, ose vete shoqerise me te njejtin cmim qe ai ka vendosur t'i shese ato. Kjo oferte do te quhet e marre nga ortaku tjetër dhe/ose nga shoqeria, ne momentin e depozitimit te saj ne seline e shoqerise.

5.4 Ne rast se ortaku tjetër i shoqerise, ose shoqeria, brenda 1 muaji nga data e depozitimit te ofertes nuk pergjigjen per kete oferte, ose refuzojne oferten, ortaku ofertues ka te drejte t'ia shese kuotat e tij paleve te treta. Kalimi i kuotave paleve të treta do të bëhet vetëm kur Asambleja e Përgjishme e Ortakëve të Shoqërisë e miraton këtë transferim me vendim unanim.

5.5 Pergjegjesia e ortakeve per humbjet e Shoqerise shtrihet deri ne vleren e kontributit te tyre ne kapitalin e Shoqerise.

## **Neni 6** **Administrimi**

Shoqeria do te administrohet nga Administratori i Vetem. Administratori do të mbajë mandatin e tij për një periudhë 5 (pese) vjecare me të drejtë të pakufizuar të rinovimit të mandatit. Administratori emërohet me shumicë të thjeshtë votash. Ripërtëritja e mandatit do të bëhet me një vendim të ri të Asamblesë së Përgjithshme, në përfundim të mandatit të parë.

Si administrator i shoqërisë emërohet:


Z. **Benard Martini**, shtetas shqiptar, lindur me 22.12.1982, ne Mjede, Shqiperi, madhor, me zotesi te plote juridike per te vepruar, banues ne Tirane, mbajtes i leternjoftimit nr. 034037524 dhe nr. Personal I21222153E.

Kompetencat dhe kufizimet ne ushtrimin e detyres se administratorit parashikohen ne statutin e shoqerise.

## **Neni 7** **Pergjegjesia Personale**

Prona personale e ortakeve, administratoreve, punonjesve dhe/ose agjenteve te Shoqerise, eshte e perjashtuar nga çfaredo lloj detyrimi qe rendon mbi Shoqerine.

## **Neni 8** **Dispozita Operative**



A2024051010002659738

Klauzolat per zhvillimin, rregullimin dhe drejtimin e aktivitetit ekonomik dhe puneve te brendeshme te Shoqerise do te percaktohen ne Statutin e Shoqerise, i cili mund te ndryshohet ne çdo kohe me vendim të kualifikuar të Asamblesë së Përgjithshme.

**Neni 9**  
**Viti Financiar**

Viti financiar i Shoqerise fillon me 1 Janar dhe mbaron me 31 Dhjetor te çdo viti. Perjashtimisht, viti i pare financiar fillon nga data e regjistrimit te shoqerise ne regjistrin tregtar dhe mbaron me 31 dhjetor 2024.

Nenshkruar nga ne ortaket themelues sot me date 08/01/2024.

**Z.Benard MARTINI**

Benard Martini

**Z.Gerjon GJOKA**

Gerjon Gjoka

Notere

